



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4763 Prot.

Ballsh, më 29 . 09 . 2022

VENDIM

Nr. 53 , Datë 28 / 09 / 2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT TË AKORDUAR PËR MBROJTJEN CIVILE

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 01, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit për vitin 2022", ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimin nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", si dhe të shkresës nr. 1007/1 prot., datë 17.06.2022 të Ministrisë së Mbrojtjes "Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022", shkresës nr. 758 prot., datë 21.07.2022 "Për marrjen e masave për ndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", të Prefektit të Qarkut Fier

VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit në vlerë 1.000.000 (njëmilion) lekë "Për harimin e planit të emergjencave civile për digat" (*pika 3.2, gërma ç*, VKM nr.414, datë 08.07.2021).
2. Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit në vlerë 1.000.000 (njëmilion) lekë "Për blerje e bazës materiale (çadra, krevatë, dyshekë, etj.) për nevoja të Sektorit të Mbrojtjes Civile" (*pika 3.1, gërma g*, VKM nr. 414, datë 08.07.2021).
3. Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit në vlerë 8.000.000 (tetëmilion) lekë "Për ndërhyrjen në frenimin e rrëshkitjeve në aksin Hekal, Klos-Poçëm" (*pika 3.1, gërma b*, VKM nr. 414, datë 08.07.2021).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes

